



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1582/2 prot.

Tiranë, më 16. 12. 2019

V E N D I M

Nr. 185, Datë 16. 12. 2019

Mbështetur në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga emisioni i transmetuar në media¹, me urdhërin Nr. 193, datë 17.10.2019, ka filluar procedurat për ndjekjen “ex officio” të çështjes : *“Gjuha e përdorur nga ana e z. K. Gj. kundrejtë komunitetit LGBTI, në emisionin ‘360 Gradë’ në Televizionin Ora News”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të administruar, në emisionin e transmetuar në Ora News, të titulluar “360 Gradë”, më datë 10.10.2019, kanë qënë të ftuar: znj. B. Gj., z. K. Gj., z. A. H., z. K. L., z. A. D., z. E. Gj. dhe në lidhje Skype, z. E. I.

Në vijim të emisionit rreth minutës 42, z. Gj. debaton me z. A. H. dhe ndër të tjera shprehet kundër martesave të të njëtit seks, si dhe kundër abortit të fëmijëve. Në minutën 53 të emisionit, në një lidhje telefonike në studion e emisionit “360 Gradë”, u përfshi në diskutim biznesmeni E. I. Gjatë diskutimit të zhvilluar, z. E. I. është shprehur ndër të tjera se: *“...nuk mund të më gjykosh mua sepse unë dua të vendos të kuq buzësh dhe kjo është çmenduri që ti ta mendosh këtë gjë në vitin 2019 në Shqipëri. Nuk besoj se shkruhet në kuran apo në bibël, që dikush që vendos të kuq buzësh bën mëkat. Nuk e di, nuk e kam lexuar ndonjëherë, unë i kam lexuar dhe kuranin dhe biblën, kështu që mos të keqpërdoren si libra...”* Në këtë moment ndërhyr z. K. Gj. duke u shprehur se: *“Ça kërkon ky tani, se s’di si ti them zonjushë,*

¹ Emisioni “360 Gradë”, i transmetuar në televizionin në Televizionin Ora News, më datë 10.10.2019, me temë “Feja hyn në politikë? Kisha katolike del hapur! Link: <https://oranews.tv/article/zbulohet-tema-te-zheji-feja-hyn-ne-politike-kisha-katolike-del-hapur>

a zonjë, a zotëri...". Pas këtij diskutimi, debati i zhvilluar ndërmjet z. K. Gj. dhe z. E. I., ka kaluar në ofendime personale, ku nga ana e të pranishmëve në emision i është tërhequr vëmendja z. K. Gj. Më tej, z. K. Gj. shprehet se: "Debati është LGBT-ja, aborti, shkatërrimi i etnogjenezës, ai thotë se njoh familjen, s'beson tek familja.". Rreth minutës 59 e në vijim, gjatë diskutimit me z. E. I., z. K. Gj. shprehet kundër tij dhe komunitetit LGBTI, si një komunitet që sjell pasoja në familjen shqiptare për shkak të orientimit të tyre seksual, duke cituar se: "...i ke fituar paratë atje me disa nga ato të tutë, ato të grupit tënd, që sponsorizojnë shkatërrimin, subsidiaritetin në botë, prandaj ju jeni diarre komplet dhe keni nevojë për pampers edhe ti biles."

Në minutën 61 të emisionit, z. A. H. vë në dijeni z. K. Gj. se është duke kryer vepër penale dhe duke përdorur gjuhë urrejtje, kundrejt z. E. I. dhe komunitetit LGBTI, në mënyrën se si diskuton. Në përgjigje të tij z. K. Gj. rreth minutës 64, shprehet kundër komunitetit LGBTI duke u cituar se ndër të tjera se: "...kam fyer komunitetin LGBT, punë e madhe, ashtu e mendoj. Vota ime do të jetë kundër komunitetit tuaj, kundër subsidiaritetit tuaj, kundër kriminelëve tuaj dhe ty që shkatërron etnogjenezën shqiptare."

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: "Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim".

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1582/1 prot., datë 25.10.2019, kërkoi informacion lidhur me shprehjeve të përdorura në media kundrejtë komunitetit LGBTI.

² Shkurtesë për ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, z. K. Gj., me anë të një postimi³ në faqen e tij në rrjetin social Facebook, më datë 29.10.2019, ka kërkuar ndjesë ndaj komunitetit LGBTI, për shprehjet e përdorura në media. Gjithashtu, në emisionin “Thumb On”, të transmetuar⁴ në televizionin Ora News, më datë 03.11.2019, ku z. K. Gj. ka qënë i ftuar, ka sqaruar se pasi Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka tërhequr vëmendjen, ai ka kërkuar falje publike. Në këto kushte, disa prej mediave on-line kanë publikuar⁵ dhe shpërndarë lajmin ku z. K. Gj. ka kërkuar falje lidhur me shprehjet e përdorura në media ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikohet objekti i këtij ligji, duke sanksionuar se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Identiteti gjinor dhe orientimi seksual, janë shkaqe për të cilat ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 608/2 prot., datë 13.05.2019

⁴ <https://www.youtube.com/watch?v=EJoKasO3tn0>

⁵ <https://boldnews.al/2019/11/01/pas-sherrit-me-biznesmenin-gay-k-gj-i-kerkon-falje-komunitetit-lgbti-ok-u-them/>

<https://www.gazeta-shqip.com/2019/11/04/burgun-gjykatën-dhe-grate-i-kam-frike-k-gj-i-kerkon-falje-publike-biznesmenit-gej-foto/>

<https://dosja.al/burgun-gjykatën-dhe-grate-i-kam-frike-k-gj-i-kerkon-falje-e-i-me-kercenuan/>

<https://www.faxweb.al/grate-i-kam-frike-k-gj-i-kerkon-falje-publike-e-i/>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*.

Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Debati, diskutimi, apo edhe shkrime në gazeta të përditshme shqiptare për çështjet e të drejtave dhe lirive të personave me identitet gjinor apo orientim seksual të ndryshëm janë të nevojshme në kushtet kur, diskutime për çështje të tilla kanë qenë një tabu. Mosnjohja në mënyrën e duhur të këtyre çështjeve bën që publiku të ketë një reagim të gabuar. Diskutime të tilla të bazuara mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjykimeve dhe stereotipeve të gabuara të personave për shkak të orientimit seksual.

Mosnjohja e këtyre çështjeve dhe qëndrimi kundërshtues ndaj tyre, vjen si pasojë e faktit se këto çështje kanë qenë për një kohë të gjatë të padukshme, të paeksponuara si dhe të ndaluara.

Dy janë identifikuar si arsye kryesore për padukshmërinë të këtyre çështjeve.⁶ Arsyeja e parë është e karakterit ligjor. Kështu, në Shqipëri deri në vitin 2001, homoseksualizmi është konsideruar vepër penale e parashikuar nga neni 116 i Kodit Penal. Homoseksualizmi është dekriminalizuar në vitin 2001, me ndryshimet që i janë bërë Kodit Penal, sipas ligjit nr. 8733, datë 24.01.2001. Arsyeja e dytë është e karakterit mjekësor. Personat me orientim seksual të ndryshëm janë konsideruar dhe vazhdojnë të konsiderohen akoma me pa të drejtë si persona të sëmurë ose që vuajnë nga ndonjë sëmundje. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) që prej vitit 1990 e ka hequr homoseksualitetin nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me Shëndetin. Shprehjet e përdorura nga z. K. Gj., janë të pabazuara dhe dezinformojnë opinion publik.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, kanë fuqinë e Konventës.

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *“Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”*, miratuar në datë 31 mars 2010, është mbajtur parasysh nga Komisioneri në këtë arsyetim, sepse ky

⁶ Studimi i Këshillit të Evropës *“Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Evropës”*, viti 2011.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

rekomandim është nxjerrë ndër të tjera duke mbajtur në konsideratë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre. Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: ***“Shtetet anëtare duhet të marrin masat e duhura për të luftuar të gjitha format e shprehjes, duke përfshirë, në media dhe në internet, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se ka gjasa për të prodhuar efektin e nxitjes, përhapjen ose nxitjen e urrejtjes apo të tjera forma të diskriminimit kundër personave gay lesbike, biseksualë dhe transeksualë. Një “gjuhë urrejtje” e tillë, duhet të ndalohet dhe publikisht të kundërshtohet kurdo që ndodh. Gjithë masat duhet të respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës.”***⁷

Pra, shohim se “gjuha e urrejtjes” kundër personave gay lesbike, biseksualë dhe transeksualë (komuniteti LGBT), ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, ashtu edhe nëpërmjet internetit, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj njerëzve LGBT. Vlerësimi nëse shprehje apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “gjuhë e urrejtjes”, duhet të bëhet në përputhje me lirinë së shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.⁸

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbron njëkohësisht lirinë e shprehjes në nenin 22 të saj ku parashikohet se: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kështu, në nenin 17, të saj sanksionohet se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*. Shohim se, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për këtë arsye, në analizën që i është bërë shprehjeve të përdorura nga z. K. Gj., nëse ato do të konsideroheshin në tejkalim të lirisë së fjalës të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, KMD i referohet kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuara në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

⁷ Përkthim i Komisionerit

⁸ KEDNJ në nenin 10 parashikon se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes”*. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çënojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve.

Në çështjen Féret kundër Belgjikës⁹, çështje në të cilën GJEDNJ ka bërë interpretime të rëndësishme, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje ndaj të huajve”*¹⁰, si dhe : *“..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”*¹¹

Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e mësipërme të çështjes Féret kundër Belgjikës, thekson në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë¹², se: *“diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”*.¹³

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që emisioni “360 Gradë” është një program i ndjekur nga shumë teleshikues dhe pjesëmarrësit për shkak të shikueshmërisë janë persona publikë si dhe televizioni “Ora News” është një televizion i ndjekur në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Rëndësia që merr liria e fjalës për personat publikë sjell dhe një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit.

Shprehjet e përdorura në adresë të komunitetit LGBTI nga z. K. Gj., krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar në lidhje me çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBTI.

Mosdiskriminimi është e drejtë kushtetuese e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,¹⁴ gjithashtu Shqipëria ka nënshkruar njëkohësisht Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14, sanksionon se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të*

⁹ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

¹⁰ Përkthim i Komisionerit

¹¹ Përkthim i Komisionerit

¹² Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012.

¹³ Përkthim i Komisionerit

¹⁴ Ne nenin 18 Kushtetuta parashikon “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”.

sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”, si dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 1 dhe 2, jep këto përkufizime: ***“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”***

Në të njëjtën frymë qëndron edhe Vendimi Nr. 61/2018 “Kodi i sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, ku në nenin 6, pika 2 parashikohet se: “...2. Deputetit i ndalohej: a) të përdorë një gjuhë të shprehuri, e cila nxit urrejtjen në bazë të racës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, besimit fetar, prejardhjes sociale, aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore ose shëndetësore, gjendjes civile, familjare ose martesore, orientimit seksual, identitetit gjinor, përgjegjësisë prindërore, predispozicionit gjenetik, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër; b) të shfaqë forma diskriminimi dhe stereotipizimi në komunikimin e përditshëm, në fjalime politike, në veprimtari parlamentare ose jashtëparlamentare ku merr pjesë.”

Gjithashtu, Rregullorja¹⁵ e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në nenet 64, 64/1 dhe 64/2 parashikon se masat disiplinore që jepen në rast se deputetët e Kuvendit përdorin gjuhë joparlamentare, diskriminuese ose kryen veprime të tjera, të parashikuara në nenin 6 të Kodit të Sjelljes, të cilat fillojnë me tërheqje vëmendjeje dhe përshkallëzohen deri në përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/komisionet parlamentare dhe organet e Kuvendit deri në 10 ditë.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë, duke mos pasur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues.

¹⁵ miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, vendimin nr. 21, datë 04.03.2010, vendimin nr. 41, datë 24.6.2010, vendimin nr. 88, datë 24.2.2011, vendimin nr. 41 datë 30.05.2013, vendimin nr. 95 datë 27.11.2014, vendimin nr. 88 datë 14.9.2017 dhe vendimin nr. 85 datë 18.7.2019

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë, përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta, synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Në kuadër të ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar në mënyrë shumë të shpejtë duke kërkuar ndjesë publike të publikuar në faqen e tij në facebook, si dhe duke bërë publik këtë qëndrim edhe në emisionin “*Thumb On*”, në Televizionin Ora News, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të gjuhës së përdorur ndaj anëtarëve të komunitetit LGBTI.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 12, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur ex-officio lidhur me gjuhën e përdorur në media ndaj komunitetit LGBTI nga z. K. Gj., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Identiteti gjinor dhe orientimi seksual)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)